



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD



ЕВРОТИНК  
ЦЕНТАР ЗА  
ЕВРОПСКИ СТРАТЕГИИ

CENTER FOR  
EUROPEAN STRATEGIES

EUROTHINK  
eurothink.mk

DOKUMENT I POLITIKAVE PUBLIKE  
***“TRANSPARENCA NË PUNËN  
POLICORE E REPUBLIKËS SË  
MAQEDONISË SË VERIUT”***



CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

**351.74:005.332.5(497.7)(047.31)**

**STOJANOVSKI, Aleksandar**

Transparenca në punën policore e Republikës së Maqedonisë së Veriut  
[Електронски извор] : dokument i politikave publike / [autorë Aleksandar  
Stojanovski, Kristina Angelevska, Dimitar Nikollovski ; përkthimi  
maqedonisht - shqip Behar Rushit]. - Shkup : Eurothink Qendra e  
strategjive europiane, 2022

Начин на пристапување (URL):

<https://eurothink.mk/2022/09/21/transparenca-ne-punen-policore-e-republikes-se-maqedonise-se-veriut/>.

- Транспарентност во работата на полицијата во Р. Северна Македонија  
документ за јавни политики / Александар Стојановски, Кристина  
Ангелевска, Димитар Николовски. - Текст во PDF формат, содржи 18 стр.,  
илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден  
23.09.2022. - Фусноти кон текстот. - Финансиер: National endowment for  
democracy të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, "Drejt policisë  
transparente, llogaridhënese dhe gjithëpërfshirëse në Republikën e  
Maqedonisë së Veriut"

ISBN 978-608-4923-57-2

1. Angelevska, Kristina [автор] 2. Nikollovski, Dimitar [автор]  
а) Полиција -- Транспарентност -- Македонија -- Истражувања

**COBISS.MK-ID 58207237**

**Botues:**  
EUROTHINK - Qendra për strategji europiane - Shkup

**Rreth botuesit (Redaktues):**  
Dimitar Nikollovski, drejtor ekzekutiv

**Autorë:**  
Aleksandar Stojanovski, Kristina Angelevska, Dimitar Nikollovski

**Rregullimi grafik:**  
Sashka Deskoska

**Përkthimi Maqedonisht - Shqip:**  
Behar Rushit

**Titulli i origjinalit:**  
Документ за јавни политики  
„Транспарентност во работата на полицијата во Република Северна Македонија“  
Александар Стојановски, Кристина Ангелевска, Димитар Николовски

**Viti 2022**

*Botimi është përgatitur në kuadër të projektit “**Drejt policisë transparente, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut**”, i zbatuar nga EUROTHINK – Qendra e Strategjive Europiane dhe i mbështetur financiarisht nga National Endowment for Democracy of the United States of America.*

*Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e National Endowment for Democracy të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ose të partnerëve të saj.*

# PËRMBAJTJA

01	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	05
02	SHËNIM METODOLOGJIK MBI AKTIVITETET HULUMTUESE TË PROJEKTIT	06
03	REKOMANDIMET	07
04	TRANSPARENCA	09
05	TRANSPARENCA NË PUNËN E POLICISË	10
06	TRANSPARENCA NË LIDHJE ME LLOGARIDHËNIEN DHE PËRGJEGJËSINË	11
07	DISKUTIME ME GRUPET E FOKUSIT ME QYTETARË	13
08	PËRFUNDIMET	16

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Projekti “Drejt policisë transparente, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut” zbatohet me qëllim që të kontribuojë në punën më të mirë të policisë dhe rritjen e besimit në policinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ky synim i projektit synohet të arrihet duke vlerësuar shkallën e llogaridhënies, transparencës dhe nivelin e vendimmarrjes gjithëpërfshirëse në punën e policisë në nivel kombëtar.

Për më tepër, qëllimi përfundimtar i kësaj sipërmarrjeje njëvjeçare është nxitja e dialogut ndërmjet policisë, medieve dhe organizatave të shoqërisë civile në nivel lokal, me shpresë se do të kontribuojë në debatin publik për siguri më të madhe në shoqërinë e Maqedonisë së Veriut.

# SHËNIM METODOLOGJIK MBI AKTIVITETET HULUMTUESE TË PROJEKTIT

## Matja e opinionit publik

Anketa telefonike e kryer në periudhën nga 23 deri më 30 nëntor të vitit 2021 nga BRIMA, në një mostër përfaqësuese prej 1001 të anketuarish, me gabim të vogël +-3%, nëpërmjet metodës CATI.

## Diskutimet e grupeve të fokusit me qytetarët

Në periudhën nga dhjetori 2021 deri në mars 2022 janë zhvilluar tetë diskutime në grupet e fokusit me 49 qytetarë, nga të cilët 28 ishin femra dhe 21 meshkuj. Grupet e fokusit janë bërë në qytetet: Shkup, Kumanovë, Tetovë, Strugë, Manastir, Shtip, Strumicë dhe Veles.

## Intervistat me nëpunësit policorë

Në periudhën nga nëntori 2021 deri në mars 2022 janë kryer 33 intervista me nëpunës policorë nga të tetë sektorët e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

## Kërkesat për qasje në informacionet me karakter publik

Në periudhën dhjetor 2021 deri në prill 2022, 92 kërkesa për qasje në informacionet me karakter publik janë dërguar në 84 institucione publike qendrore dhe lokale (të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale, MPB, Avokati i Popullit, Prokuroria Publike e Ndjekjes së Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit).

### Për Ministrinë e Punëve të Brendshme:

#### 01 Për transparencën e përmirësuar pasive:

- Të përmirësojë kategorizimin e publikimeve, dokumenteve dhe informacioneve në faqen e saj të internetit, të cilat lidhen me punën dhe rezultatet e punës, që janë të detyrueshme dhe rrjedhin nga ligjet dhe procedurat e brendshme të punës (raportet vjetore, strategjitë, njoftimet për shpallje dhe blerjet publike dhe të tjera);
- Të mundësojë kërkimin e informacionit që publikohet në faqen e saj të internetit;
- Të përshtaten rregullat dhe procedurat e brendshme për klasifikimin e informacionit me kornizën ligjore, për të lehtësuar qasjen në informacionin publik;
- Të prezantojë lokalizimin/rajonalizimin e informacionit të publikuar në faqen e tij dhe në mediet sociale sipas qyteteve/rajoneve, që do të mundësojë vendosjen e informacionit përkatës për qytetarët sipas fushëveprimit të tetë rajoneve planifikuese, përkatësisht kompetencës së tetë rajoneve, Departamentet e Punëve të Brendshme. Ky informacion mund të kategorizohet sipas natyrës së tij (p.sh. shtypja e krimit dhe kundërvajtjeve; parandalimi, domethënë edukimi, informacioni i shërbimit, personat e zhdukur, kërkimet, etj.).

#### 02 Për transparencën aktive të përmirësuar (publikim i pavarur dhe proaktiv i informacionit që është me interes për publikun dhe qytetarët):

Të përshtatet mënyra për të ofruar qasje në të dhënat e hapura për publikun, përmes ndërtimit të sistemeve inteligjente dhe interaktive për shfaqjen në kohë të të dhënave publike, të cilat do të ofrojnë qasje në të dhënat statistikore për shkallën e krimit, punën dhe rezultatet e tij të ndara sipas rajoneve gjeografike dhe parametrave të tjerë.

Edhe pse në portalin data.gov.mk tashmë janë 32 grupe të dhënash, faqja e internetit e MPB-së duhet t'i bëjë të disponueshme dhe të detajuara për publikun dhe mediet të dhënat për punën e saj, duke krijuar grupe shtesë të hapura të të dhënave, të cilat i referohen:

- Numrit dhe llojit të thirrjeve për përfshirjen e komuniteteve dhe qytetarëve në aktivitete të caktuara, p.sh. procese që kanë të bëjnë me sigurinë, parandalimin ose edukimin;
- Numrit dhe llojit të informacionit të shërbimit (në lidhje me punën e organeve të shërbimit administrativ, lëvizjen dhe trafikun, kalimet kufitare, emergjencat, pandemitë);
- Origjinës dhe numrit, pra llojit të thirrjeve në 112 ose 192;
- Numrit të aksidenteve në komunikacion dhe gjatë lëvizjes;
- Numrit të incidenteve dhe rasteve të cenimit të rendit dhe qetësisë publike;
- Numrit të identifikimit, bastisjeve, heqjes së lirisë, dënimeve me gjoba dhe urdhërpagesave;
- Numrit të rasteve kur është përdorur forca;
- Numrit dhe llojit të krimeve të urrejtjes;
- Numrit të sulmeve ndaj zyrtarëve;
- Numrit të rasteve kur ka përdorim të armëve ose përlëshje të armatosura me nëpunës policorë;
- Numrit të ankesave, përkatësisht raporteve në Departamentin e Kontroll të Brendshëm dhe Standardeve Profesionale;
- Të dhënave demografike për anëtarët, përkatësisht kandidatët për anëtarë të MPB-së;
- Të ndryshme.

### **Për mediet dhe punjësit e medieve:**

- Duke mbajtur kontakte dhe komunikim të rregullt me Departamentin e Marrëdhënieve me Publikun dhe Çështjeve Strategjike në kuadër të MPB-së, të përpiqen të marrin informacione në kohë dhe të sakta që u nevojiten për realizimin e aktiviteteve informative dhe hulumtuese;
- Të inkurajojë MPB-në që të përmirësojë cilësinë dhe mënyrën e informimit të publikut dhe punonjësve të medieve, përkatësisht transmetuesve publikë, me qëllim të rritjes së vetëdijes së qytetarëve. Përmes komunikimit të drejtpërdrejtë me Departamentin e Marrëdhënieve me Publikun dhe Çështjeve Strategjike në MPB, të kontribuojë në luftën kundër dezinformatave dhe lajmeve të rreme.



## TRANSPARENCA

Termi “**transparencë**”, në kuptimin literal, nënkupton mundësi të shihet nëpërmjet ndonjë gjëje përkatësisht dukurie, më pas duke mundësuar të vërehet se çfarë qëndron prapa asaj gjëje përkatësisht dukurie.

Në përkufizimin e termit “transparencë” për qëllimet e këtij dokumenti për politikën publike, duhet të bëhet lidhja e përkufizimit të dhënë dhe kontekstit të administratës publike, edhe atë në kuptim të rregullimit demokratik të një shoqërie. **Transparenca institucionale është shkalla ku një institucion publik përkatësisht institucion, duke lejuar që palë të tjera të përfshira përkatësisht faktorët të jashtëm, t’i ndjekin dhe t’i vlerësojnë proceset dhe performancat e saj.** Këtu detektohet lidhja e ngushtë mes koncepteve “transparencë” dhe “llogaridhënie”, prandaj konsiderohet se **transparenca është parakusht për ekzistimin e llogaridhënies.** Më tej, është e rëndësishme të bëhet dallimi mes dy llojeve të transparencës- pasive dhe aktive.<sup>1</sup> **Transparenca aktive quhet forma që paraqet obligim ligjor ndërsa transparenca pasive është forma e transparencës që në teori njihet si “vullnetare” përkatësisht jo-obligues.**

Nëpërmjet përpjekjeve për zhvillimin dhe funksionimin e përmirësuar, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe institucionet e saj ballafaqohen me sfidën e “transparencës”, që paraqet një nga parimet e sundimit demokratik modern dhe të avancuar.<sup>2</sup> Andaj, mund të thuhet se ndërtimi i kulturës së transparencës në formulimin e politikave publike dhe realizimi i qëllimeve dhe obligimeve që u jepen institucioneve, është proces kompleks. Në rastin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përpjekjet për integrim në NATO dhe në Bashkimin Europian, krijojnë efekt katalitik ndaj ngritjes përkatësisht ndaj zhvillimit të transparencës institucionale.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> Mary Ellen Guy, Todd L. Ely “Esencialet e Shërbimit Publik: Hyrje në Administratën Publike Bashkëkohore” [Essentials of Public Service: An Introduction to Contemporary Public Administration] Melvin&Leigh, Publikues, 2018, f. 332

<sup>2</sup> “Gjetje kuqe nga raporti i Komisionit Europian për Republikën e Maqedonisë së Veriut 2021” [Клучни наоди од извештајот на Европската комисија за Република Северна Македонија за 2021 година] [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda\\_21\\_5280](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda_21_5280).

<sup>3</sup> “Plani nacional i veprimit për partneritet të hapur qeveritar 2018–2020” [Национален акциски план за отворено владино партнерство 2018–2020 година] [https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2018/09/Macedonia\\_Action-Plan\\_2018-2020\\_MAC.pdf](https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2018/09/Macedonia_Action-Plan_2018-2020_MAC.pdf)

## TRANSPARENCA NË PUNËN E POLICISË

Për policinë, transparenca është ngushtë e lidhur me parimin e hapjes gjatë realizimit të punëve policore, që delegohen në këtë institucion kyç (sidomos në kontekst të rolit të shërbimit publik) ndërsa në suazat e një shoqërie demokratike. **Transparenca si parim i punës demokratike policore, duhet të vihet në funksion të parashikimit të kompetencave të organizatës dhe të bazohet në informacionet e disponueshme për opinionin, vendimet që merren, rregullat dhe rregullativat sipas të cilave vepron policia.**

Në kornizën juridike të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më saktë në Ligjin e Policisë “parimi i hapjes” është i rregulluar në nenet 9, 10, 11 dhe 21.<sup>4</sup> Në Ligjin e Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, parimi i hapjes rregullohet me nenin 5 ndërsa parimi i transparencës me nenin 11.<sup>5</sup> Këto akte juridike përkufizojnë formën pasive të transparencës së këtij institucioni në sistemin juridik.

“**Strategjia e përfshirjes dhe komunikimit me komunitetin 2020-2022**”<sup>6</sup> e MPB-së është dokument kyç, i cili mes tjerash, ka të bëjë me format e hapjes dhe transparencës gjatë punës së policisë. Ky dokument strategjik e përpunon problematikën e transparencës në kuptimin e komunikimit jashtë (indirekt dhe të drejtpërdrejtë). Këtë e bën nëpërmjet skicimit të sfidave dhe mungesave në praktikata e deritanishme të punës dhe në kontekst të përmirësimit të formës aktive të transparencës. Më tej, në “**PLANIN STRATEGJIK 2022-2024**”<sup>7</sup>, i miratuar në mars të vitit 2022, **MPB e detekton komunikimin dhe transparencën si vegël kyç në punën e saj.** Nëpërmjet këtyre dy dokumenteve, policia angazhohet për nxitjen e formës aktive të transparencës, krahas obligimeve të përcaktuara ligjore.

<sup>4</sup> “Ligji i Policisë i Republikës së Maqedonisë së Veriut” [Закон за полиција на Република Северна Македонија] [https://mvr.gov.mk/Upload/Documents/Zakon%20za%20policija,%20precisten%20april%202022\(1\).doc](https://mvr.gov.mk/Upload/Documents/Zakon%20za%20policija,%20precisten%20april%202022(1).doc).

<sup>5</sup> “Ligji i Punëve të Brendshme i Republikës së Maqedonisë së Veriut” [Закон за внатрешни работи на Република Северна Македонија] [https://mvr.gov.mk/Upload/Documents/ZVR%20PRECISTEN%20TEKST%20april%202022\(1\)\(1\).doc](https://mvr.gov.mk/Upload/Documents/ZVR%20PRECISTEN%20TEKST%20april%202022(1)(1).doc).

<sup>6</sup> “Strategjia e përfshirjes dhe komunikimit me komunitetin 2020–2022” [Стратегијата за вклучување и комуникација со заедницата 2020–2022] [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/strategii/CEC%20STRATEGY\\_MK.pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/strategii/CEC%20STRATEGY_MK.pdf).

<sup>7</sup> “PLANI STRATEGJIK 2022–2024” [СТРАТЕШКИ ПЛАН 2022–2024 година] [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/220310%20SP%20na%20MVR%202022-2024.pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/220310%20SP%20na%20MVR%202022-2024.pdf).

## TRANSPARENCA NË LIDHJE ME LLOGARIDHËNIEN DHE PËRGJEGJËSINË

Si organ i administratës publike, policia është institucion i financuar nga mjetet e obliguesve tatimor dhe si i tillë, pritet të ketë llogaridhënie ndaj opinionit. **Mekanizmat e llogaridhënies duhet të garantojnë paanshmëri në rastet ku ekziston dyshimi për: keqpërdorim të pozitës zyrtare, brutalitet policor, profilim etnik, gjinor dhe formë tjetër të profilimit përkatësisht diskriminimit, si brenda ashtu jashtë organizatës.** Kjo përfshin mirëmbajtje dhe mundësim të funksionimit të papenguar të trupave efektiv dhe të pavarur që do t'i mbrojnë, para se gjithash, interesat e komunitetit dhe shoqërisë si tërësi.

Për këtë segment, kyç është njoftimi në kohë dhe transparent për epilogun e punës së Departamentit të kontrollit të brendshëm, hetimeve kriminalistike dhe standardeve profesionale, por edhe mekanizmave të jashtëm për kontroll ndaj punës së policisë, siç janë: Departamenti i specializuar i hetimit dhe ndjekjes së veprave penale, të kryera nga persona me autorizime policore dhe zyra e Avokatit të popullit. **Është e rëndësishme të përmendet se për punën e Departamentit të kontrollit të brendshëm, hetimeve kriminalistike dhe standardeve profesionale, Ministria publikon raporte në bazë të rregullt dhe për epilogët e punës së kontrollit të brendshëm ka raporte tremujore, krahas raportit vjetor,** dhe ato publikohen në faqen e internetit e MPB-së nën rubrikën: “Kontrolli i brendshëm”.

Më pas, **publikimi i dokumenteve, siç janë raportet vjetore, financiare dhe të revizionit,** të përgatitura nga revizori shtetëror si dhe dokumente tjera publike lidhur me punën e këtij institucioni, është standard i artë në ruajtjen e transparencës. Një nga aspektet kyç që ndikojnë në imazhin e organeve të administratës publike është transparenca, edhe atë në kontekstin e qasjes së informacioneve që i mundësojnë institucionet. Si organ i administratës publike, **policia ka numër të madh të fuqive dhe kompetencave që prekin në liritë dhe të drejtat e qytetarëve dhe prandaj transparenca në masë të madhe ndikon në shkallën e besimit në të.**

Raporti vjetor i punës së MPB-së për vitin 2021<sup>8</sup> jep informacione të sistematizuara për punën e këtij institucioni në fushën e marrëdhënieve me opinionin dhe transparencës. **Megjithatë, është e rëndësishme të përmendet se raporti vjetor është praktikisht e pamundur të detektohet në vetë faqen e internetit e institucionit.** Edhe pse ueb-faqja është përplot me rubrika dhe pjesë të veçantë lidhur me publikimin e dokumenteve të obligueshme, akteve juridike dhe informacioneve që, sipas parimeve të transparencës pasive, duhet të jenë dhe janë të kapshme për opinionin, megjithatë, mungojnë raportet vjetore, financiare dhe të revizionit, që i posedon ky institucion. Funkcioni për kërkim në faqen e internetit e MPB-së nuk është në funksion. Deri te raporti vjetor për punën e MPB-së mund të arrihet me ndihmën e kërkuesve, ndërsa në të njëjtën kohë, për publikimin e këtyre dokumenteve mungon publikim përkatës i liferuar në rubrikën “lajme”.

Sipas hulumtimit të opinionit publik EUROMETAR 2021, një nga pesë qytetarët konsiderojnë se policia është transparente, kundrejt dy nga pesë të anketuar që nuk konsiderojnë se policia është transparente për punën e saj. Dy nga pesë të anketuar të përfshirë në ekzemplar kanë mendim neutral lidhur me shkallën e transparencës së policisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### Teksti-boks nr. 1: Ekstrakt nga hulumtimi i mendimit publik "Eurometri, dimër 2021"<sup>9</sup>

22% e të anketuarve janë pajtuar me pohimin se "policia në Maqedoni është transparente në punën e saj" (nota 4 dhe 5), ndërsa 40% e të anketuarve në ekzemplar kanë shprehur mospajtim me këtë pohim (nota 1 dhe 2). Pothuajse një e treta e ekzemplarit, pra 36% e të anketuarve kanë dhënë vlerësim neutral për këtë pohim (nota 3).

<sup>8</sup> Raporti vjetor i punës së MPB-së për vitin 2021 [Годишен извештај за работата на МВР за 2021 година] [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/Godisen%20izvestaj%20na%20MVR%20za%202021%20godina,%20%20-%2015\\_04\\_2022.pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/Godisen%20izvestaj%20na%20MVR%20za%202021%20godina,%20%20-%2015_04_2022.pdf).

<sup>9</sup> Stojanovski, Aleksandar "Perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut për punën e policisë" [Перцепции и ставови на граѓаните на Република Северна Македонија за работата на полицијата], hulumtim i opinionit publik, Eurometri 2021, fq.9 [shorturl.at/lpV04](http://shorturl.at/lpV04)

## DISKUTIME ME GRUPET E FOKUSIT ME QYTETARË

Për sa i përket transparencës së policisë ndaj qytetarëve, te diskutuesit në grupet e fokusit mbizotëronin mendime të ndryshme. Disa diskutues mendojnë se MPB-ja nuk sillet në mënyrë transparente. Arsyet e qëndrimeve të tilla i shohin në përhapjen e pamjaftueshme të informacioneve për aktivitetet jorepresive që i zbaton policia, përkatësisht: informacione të karakterit shërbyes, njoftime lidhur me parandalimin ose dhënien e dokumenteve dhe dokumenteve të udhëtimit. Në të njëjtën kohë, krahasuar me transparencën e policisë prej para 10-15 viteve, pjesëmarrësit në diskutimet me grupet e fokusit, në përgjithësi, konsiderojnë se deri diku është rritur transparenca e institucionit, por jo në nivelin e duhur.

Për punën e policisë diskutuesit me grupet e fokusit më së shumti informohen nëpërmjet medieve (televizione dhe medie elektronike apo të shkruara). Një pjesë e vogël e diskutuesve i kanë vizituar ose janë informuar për ekzistencën e faqeve zyrtare të MPB-së në rrjetin social Facebook ose YouTube. Tek ata mbizotëron qëndrimi se policia "ndihet e shtypur" nga opinioni, por edhe nga tendencat moderne për ndarje më të shpeshtë të informacionit lidhur me rezultatet e punës së tyre. Njëra nga bashkëbisedueset shprehu qëndrim pozitiv për transparencën e policisë, veçanërisht për transparencën e kontrollit të brendshëm dhe theksoi se sipas përvojave të saja, MPB-ja i përgjigjet në mënyrë transparente dhe profesionale çdo kërkesë të paraqitur për informacion rreth procedurave para Departamentit të Kontrollit të Brendshëm, Hetimeve Kriminallistike dhe Standardeve Profesionale.

Sipas pjesëmarrësve në diskutime, transparencë ekziston kur mund të shihet se si funksionon institucioni, si zhvillohet dhe si zhvillohet si shërbim publik, por edhe sa është shkalla e integritetit. Për disa individë, policia tani është më e mbyllur se kurrë, ndërsa, për diskutuesit e tjerë, policia është më transparente sesa në disa momente në të kaluarën.

Në pjesën më të madhe, diskutuesit e përfshirë në diskutimet me grupet e fokusit nga të tetë rajonet e planifikimit, konsiderojnë se MPB-ja, si institucion, është pjesërisht transparente për opinionin, me përjashtim të ndarjes aktive të informacionit për kundërvajtjet dhe veprat e kryera penale, respektivisht plasimin e informacioneve për dukuritë negative dhe të ashtuquajturën "kronika e zezë".

Në kuadër të intervistave të strukturuar me nëpunës policorë, policia vlerësohet me notë të lartë për shkallën e transparencës. Nga 33 intervista të kryera me nëpunës policorë, në të tetë Sektorët e Punëve të Brendshme të MPB-së, rezultati i mesatar (në shkallën nga një deri në pesë) është 3,95. Kjo flet për perceptimin e të punësuarve, ku vetë organizata e policisë cilësohet si përafërsisht e hapur dhe transparente jashtë. Nëpunësit me më shumë vite në shërbim e kanë vërejtur rritjen e aktivitetit në fushën e informimit të opinionit në vitet e fundit, krahasuar me praktikat që ekzistonin disa dekada më parë.

**Tabela nr. 1: Rishikimi statistikor i postimeve në faqen e internetit e Ministrisë së Punëve të Brendshme në vitin 2021**

Llojet e publikimeve në faqen e internetit e MPB-së në vitin 2021	Numri i publikimeve
Lajm-statistikë	9
Përfshirja e komunitetit	10
Ftesë për medie	27
Informacioni i shërbimit	46
Informacion për aktivitet ose njoftim	301
Informacion për krim ose shkelje	2080
<b>Gjithsej</b>	<b>2473</b>

Analiza e kryer në lidhje me numrin dhe llojin e publikimeve në faqen zyrtare të MPB-së për vitin 2021 tregon një rubrikë “lajme” të përditësuar shpesh. Nga numërimi dhe klasifikimi i kryer i publikimeve, është evidente se në pesë vitet e fundit opinioni merr rregullisht një numër të madh informacionesh individuale për punën e këtij institucioni. Gjatë vitit 2021, mesatarisht më shumë se gjashtë publikime në ditë janë vendosur në faqene internetit e MPB-së në rrjetin sociale Facebook.

Në momentin e mbylljes së analizës, faqet zyrtare të MPB-së në rrjetin social Facebook, si dhe në YouTube, kanë një numër serioz ndjekësish (mbi 65.000).

Gjatë vitit 2021 në kanalin YouTube të Ministrisë së Brendshme janë publikuar 561 video. Ministria, përmes Departamentit të Marrëdhënieve me Publikun dhe Çështjeve Strategjike, arrin të tërheqë një numër të madh vizitash ditore në kanalet e saja zyrtare në këto media sociale. Sipas Raportit Vjetor për vitin 2021, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun dhe Çështjeve Strategjike është përgjigjur ndaj 2600 kërkesave me shkrim të gazetarëve dhe medieeve. Në të njëjtën periudhë janë pranuar mbi 4000 shkresa nga qytetarë dhe institucione, të cilave MPB-ja u është përgjigjur ose ua ka përcjellë institucioneve apo shërbimeve kompetente.

Duke marrë parasysh numrin e lajmeve të publikuara nga MPB-ja gjatë një viti kalendarik, vendosja e tageve, respektivisht fjalëve kyçe në vetë publikimet dhe kategorizimi i informacioneve sipas llojit/natyrës dhe vendndodhjes, do të ndihmonte në navigimin më të lehtë nëpër to, si dhe në kërkimin e tyre.

## PËRFUNDIMET

Sipas rezultateve të hulumtimit të mendimit publik, përqindja e qytetarëve që e konsiderojnë policinë transparente në punën e saj korrespondon me përqindjen e qytetarëve që kanë shprehur besim tek policia si institucion. Një në pesë të anketuar ka besim tek policia si institucion, pra janë të bindur se policia është transparente në punën e saj. Kjo tregon korrelacionin që ekziston mes perceptimit të transparencës dhe besimit në këtë institucion.

**Gjatë diskutimeve me qytetarët**, tërësisht janë përfshirë mendimet dhe qëndrimet e tyre dhe, ndryshe nga intervistat me nëpunësit policorë, ky grup i larmishëm qytetarësh diskutuan dhe analizuan hapur punën e policisë në bashkësitë e tyre lokale, duke u fokusuar në mënyrë konkrete në transparencën, gjithëpërfshirjen në vendimmarrje, koncepti "policia në komunitet", llogaridhënia e policisë dhe efikasiteti i saj në bashkësitë lokale.

Në parim, për pjesëmarrësit në grupet e fokusit, definicioni i transparencës dhe llogaridhënies është mjaft i ngjashëm. Disa nga bashkëbiseduesit besojnë se policia është përgjegjëse për informacionet që shpërndan në rrjetin e saj social dhe në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Disa e konsiderojnë llogaridhënien e MPB-së si të plotë dhe për këtë arsye transparenca është e kufizuar. Për sa i përket transparencës së policisë, të pranishmit vlerësojnë se Ministria e Punëve të Brendshme është larg atij koncepti të hapur dhe demokratik të punës dhe për këtë arsye mendojnë se qytetarët nuk janë mjaftueshëm të informuar për punën e policisë në fushën e krijimit të politikave që e diktojnë drejtimin e punës.

Sipas tyre, **polici transparente dhe llogaridhënëse** nënkupton që MPB-ja rregullisht të tregojë se çfarë është punuar në fushën e përgjegjësisë dhe ruajtjes së standardeve profesionale.




Në pyetjen se si mendojnë se një shërbim publik si policia duhet të komunikojë me opinionin, diskutuesit deklaruan se **prania e shërbimit informativ dhe fushatave edukative për parandalimin e dukurive devijuese, që nënkuptojnë prishjen e rendit dhe qetësisë publike, si dhe të sigurisë në trafik, duhet të jenë më të përfaqësuar në komunikimet e përditshme me opinionin.**

Disa qytetarë të përfshirë në grupet e fokusit, të cilët kanë pasur përvojë në kërkimin e qasjes në informacione publike, besojnë se ky mekanizëm funksionon dhe se Ministria e Punëve të Brendshme, në rastet e tyre, i ka ndarë informacionet që janë kërkuar.

Policia është manifestimi më i dukshëm i organeve qeveritare përgjegjëse për sigurinë publike. Transparenca e policisë është e rëndësishme, sepse është e vetmja mënyrë për të pasur opinion të informuar për sfidat dhe problemet e sigurisë në një shoqëri, por edhe për ta marrë mbështetjen e opinionit në menaxhimin e tyre.

**Transparenca në zbatimin e punës së policisë, siç është ruajtja e rendit dhe qetësisë publike, nuk është qëllim në vetvete. Në këtë kontekst, është mjet për arritje më të lehtë të sigurisë dhe stabilitetit në një mjedis.** Transparenca në punën e policisë është mjet për të riafirmuar tezën se policia është shërbim publik që funksionon në interes të qytetarëve, pra taksapaguesve dhe jo në interes të dikujt tjetër. Me rritjen e transparencës së policisë, rritja e besimit është gjithashtu e pashmangshme, sepse ekziston marrëdhënie e ndërsjellë midis këtyre dy koncepteve.



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD



eurothink.mk